



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Kryetarja

Nr. 1895 Prot.

Tiranë, më 14.05. 2024

URDHËR

Nr. 28, datë 14.5.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 16.5.2024 ORA 10:00.

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 29 prill – 18 maj 2024,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 16.5.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 9.5.2024.
 2. Njoftime.
 3. Interpelancë me Kryeministrin, zotin Edi Rama kërkuar nga deputeti Tritan Shehu.
 4. Pyetje e deputetes Erisa Xhixho drejtuar Ministres së Arsimit dhe Sportit, Zonjës Ogerta Manastirliu.
 5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore”.
 6. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL, mbi privilegjet dhe imunitetet për Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane, që do të mbahet në Shqipëri në vitin 2024”.
 7. Projektligj “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.
 8. Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetëtare të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve””, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008,të ndryshuar”.

9. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit”.
 10. Projektligj “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”.
 11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
- III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 16 maj 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrin nr. 28, datë 14.5.2024 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 9.5.2024.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë me Kryeministrin, zotin Edi Rama, kërkuar nga deputeti Tritan Shehu.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 96 i Rregullores së Kuvendit).
4. **Pyetje e deputetes Erisa Xhixho drejtuar Ministres së Arsimit dhe Sportit, zonjës Ogerta Manastirliu.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 95 e Rregullores së Kuvendit).
5. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe neni 121, pika 1 të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Dhënie mendimi Komisioni Çështjet Europiane
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit

6. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL, mbi privilegjet dhe imunitetet për Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane, që do të mbahet në Shqipëri, në vitin 2024.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, dhe nenit 121, pika 1 të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. **Projektligj “Për Ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

8. **Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetëtare të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve””, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar”.**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit

9. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit”.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Dhënie mendimi Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

10. **Projektligj “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.

Diskutime

11. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)